

EKSTRAKT

MBI AUDITIMIN E KREYR NË AKT TIRANË

Në zbatim të programit të auditimit nr.601/2, datë 27.11.2013 i ndryshuar, të miratuar nga Ministri, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar angazhim/mision auditimi në Agjencinë Kombëtare të Turizmit (AKT) Tiranë, për periudhën 01.01.2011-30.09.2013, me objekt zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë.

Grupi i auditimit gjatë realizimit të këtij angazhimi ka konstatuar gjetjet e mëposhtme:

1. Konstatohet se është bërë punë e pamjaftueshme për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, ku nga 15 rekomandime të lëna, nuk janë realizuar 6 prej tyre ose niveli i mosrealizimit është 40 %, duke përfshirë dhe arkëtimin në 3 raste të dëmeve të konstatuara nga auditimi i mëparshëm, për vlerën 449.674 lekë.

2. Për procesin e ndwrtimit dhe arredimit të stendave, në zhvillimin e panaireve kombëtare e ndërkombëtare, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar. *Kështu,*

-Në vitin 2011, AKT ka marrë pjesë në 10 panaire, me një kosto ndërtimi dhe arredimi stende në shumën 85.419 Euro, realizuar nga 4 kompani, prej të cilave kompania "Cerioni Allestimenti" Itali, ka realizuar ndërtimin dhe arredimin e stendës në 2 panaire (Milano & Berlin).

-Në vitin 2012, AKT ka marrë pjesë në 6 panair, me një kosto ndërtimi dhe arredimi stende në shumën 91.045 Euro, realizuar nga 4 kompani, prej të cilave kompania "Cerioni Allestimenti" Itali, ka realizuar përsëri ndërtimin dhe arredimin e stendës në 2 panaire si në vitin 2011 (Milano & Berlin).

-Në vitin 2013 AKT ka marrë pjesë në 3 panaire, me një kosto ndërtimi dhe arredimi stende në shumën 56.715 Euro, realizuar nga kompania "Paneks" - Shkup, Maqedoni.

Në total për të tre vitet 2011-2013, kosto e ndërtimit dhe arredimit të stendës është në shumën 233.179 Euro ose 32.6 milionë lekë, për të cilat nuk është kryer asnjë procedurë prokurimi.

Rezultojnë diferenca në kostot e ndërtimit dhe arredimit të stendës, për Panairin e Milanos, që e analizuar sipas kompanive që kanë realizuar punimet, për vitet 2011-2013 paraqitet kjo gjendje:

Nr	Vitet	Sipërfaqe	Kosto ndërtimi & arredimi	Kontraktuesi
1	2011	80 m2	10.237 Euro	Cerioni Allestimenti, Itali
2	2012	58.5 m2	10.850 Euro	Cerioni Allestimenti, Itali
3	2013	58.5 m2	17.205 Euro	Paneks, Shkup, Maqedoni

Sa më sipër, për gjithë periudhën 3 vjeçare 2011-2013, nuk janë zhvilluar procedura të prokurimit publik, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643/ 2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar.

✿ 3. Mosnxjerrje e përgjegjësi, për vendimet gjyqësore, si pasojë e veprimeve të paligjshme të largimit nga puna të punonjësve nga institucioni, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe Udhëzimit të MF nr.4, datë 27.01.2011, "Për zbatimin e buxhetit të viti 2011", pika 6.1 "Vendimet Gjyqësore", e cila ka sjellë dëm efektiv për buxhetin e shtetit, në shumën 9.782 mijë lekë.

✿ 4. Mosndjekje dhe mosarkëtim të detyrimeve të subjekteve "person i stimuluar", që "*de facto*" vazhdojnë të përdorin pronën (truallin e marrë me qira), edhe pse "*de jure*" marreveshjet janë zgjidhur. Për më tej, urdhrin për zgjidhjen e marreveshjeve këto subjekte e përdorin edhe si shkak për mospagimin e detyrimeve të qirasë. Nga auditimi rezulton një gjendje shumë e lartë e detyrimeve të subjekteve private që kanë statusin e "personit të stimuluar" ndaj shtetit, për marreveshje qiraje dhe zhvillimi.

✿ 5. Nuk janë paraqitur për miratim tek ministri përgjegjës për Turizmin dhe ministri i Financave, tarifat në lidhje me nxjerrjen e të ardhurave nga pjesëmarrja e subjekteve private në panairët e turizmit, detyrim ky në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2006, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore", i ndryshuar.

✿ 6. Për periudhën e audituar, Janar 2011 - Shtator 2013, u konstatua se vetëm në një rast, Agjencia Kombëtare e Turizmit ka hartuar dhe dërguar për miratim në MTKRS "Planin e promocionit dhe marketingut për vitin 2011".

✿ 7. Në administrimin financiar të fondeve, për biletat e fluturimit, me avion jashtë vendit, në asnjë rast, nuk janë kryer procedurat e prokurimit të parashikuara në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", VKM nr. 2, datë 18.02.2008, "Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla", me ndryshime, etj.

✿ 8. Në të gjitha aktivitetet dhe panairët e organizuara nga AKT, për periudhën 2011 -2013, janë angazhuar e marrë jashtë shtetit pa asnjë lloj kontrate shërbimi gazetarë të televizioneve private, të cilëve u janë përballuar të gjitha shpenzimet nga AKT.

✿ 9. Në organizimin e tenderave për, blerjen e materialeve promocionale, spoteve mbi turizmin dhe blerjen e kohës televizive janë konstatuar shkelje dhe parregullsi ligjore, që janë trajtuar hollësisht në raportin e auditimit.

🌸 10. Mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm:

Nw zbatim tw nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, vlerësojmë që: titullarët e kësaj njësie publike, në vijimësi, nuk kanë vendosur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomi, efektivitet dhe eficensë. *Përgjithësisht, sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar si një proces integral e i vazhdueshëm, duke mos zbatuar ligjshmërinë dhe aktet ligjore në fuqi, fakt që ka sjellë një nivel risku të lartë.* Këto evidentohen nga parregullsitë financiare me dietat, parregullsitë administrative me emërimet, mungesa të koordinimit për plotësimin e nevojave me shërbime, shkelje në prokurimin e fondeve, për bileta fluturimi, dobësi në arkëtimin e detyrimeve, për marrëveshjet e qirasë dhe të zhvillimit, etj.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, të trajtuara gjatë procesit të auditimit, të evidentuara në projekt raportin dhe në raportin final të angazhimit të auditimit, për përmirësimin e punës në të ardhmen, mbështetur në kërkesat e Ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, në Manualin e Auditimit të Brendshëm (miratuar nga MF me nr. 69, datë 29.9.2010), Udhëzimit të MF nr. 12, datë 29.06.2012, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, janë rekomanduar për zbatim:

1. 1 masë për përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi.
2. 11 masa organizative dhe të forcimit të kontrolleve të brendshme.
3. 8 masa të shpërblimit të dëmeve , nga 16 subjekte, për vlerën 8,2 milionë lekë.
4. 8 masa disiplinore ndaj zyrtarëve, nga këto, 1 largim nga puna, 1 largim nga detyra, 3 vërejtje me shkrim dhe 1 vërejtje me paralajmërim.